



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. 1389 / prot.
4

Lezhë, më: 23-07-2026

NJOFTIM

**“PËR ORGANIZIMIN E DËGJESËS PUBLIKE PËR
DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR KOMBËTAR, SHOQËRISË “F K
ENERGY” SH.P.K, PËR VENDOSJEN E ANTENËS PËR MATJEN E
REZULTATEVE TË ERËS NË MALIN E RRENCIT, NJËSIA ADMINISTRATIVE
SHËNGJIN DHE PËR VENDOSJEN E ANTENËS PËR MATJEN E REZULTATEVE
TË ERËS NË MALIN E KAKARRIQIT, NJËSIA ADMINISTRATIVE BALLDRE,
BASHKIA LEZHË**

Bashkia Lezhë, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqëverisjen vendore”, në ligjin Nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, në VKM-në 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, në ligjin 57/2020 “Për Pyjet”, si dhe në Projekt Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Lezhë nr. _____ prot, datë _____.2026, për dhënie në përdorim të fondit pyjor kombëtar, shoqërisë “F K ENERGY” sh.p.k, për vendosjen e antenës për matjen e rezultateve të erës në Malin e Rrencit, Njësia Administrative Shëngjin dhe për vendosjen e antenës për matjen e rezultateve të erës në Malin e Kakarriqit, Njësia Administrative Balldre, Bashkia Lezhë organizon dëgjuesën publike për informimin e komunitetit dhe grupeve të interesit lidhur me këtë procedurë.

Në vijim të procesit të konsultimit me publikun, ju ftojmë të merrni pjesë në dëgjuesën publike, **ditën e enjte, datë 20.08.2026, ora 11:00**, në sallën e Bibliotekës “Gjergj Fishta” Lezhë.

Gjatë takimit të dëgjuesës publike do bëhet prezantimi i dokumentacionit lidhur me kërkesën për marrjen në përdorim të sipërfaqes pyjore të kërkuar nga shoqëria “F K ENERGY” sh.p.k.

Ju mirëpresim për të ndarë mendimet tuaja!

KRYETARI
Pjerin NDREU

